



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.559/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kundërshtimi i vendimit të KVO lidhur me rivlerësimin në pikë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2T” shpk në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-65458-07-14-2020, me objekt Loti X “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Berat - Çorovode + rruga Çorovode - Hambull + rruga Hambull - Rog”, me fond limit 168,938,495.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

“2T” shpk
Rruga Asim Vokshi, nd.14, H.4, Ap.4 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Subjekte të interesuara:

“Salillari” shpk
Lagjia Vore, Rruga e vjeter Vore-Marikaj Km 1

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i

Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e

prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-65458-07-14-2020, me objekt Loti X “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Berat - Çorovode + rruga Çorovode - Hambull + rruga Hambull - Rog”, me fond limit 168,938,495.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 8781/1 datë 18.11.2020 si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 05.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Në këtë fazë kanë marrë pjesë operatorët si më poshtë.

- Salillari I kualifikuar
- 2T I kualifikuar
- Sireta 2F I kualifikuar
- G.P.G Company I kualifikuar
- 6D –Plan I skualifikuar
- Agbes Konstruksion I kualifikuar

II.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pas mbylljes së fazës së parë dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor më datë 09.09.2020 me shkresën nr.4795/12 nëpërmjet sistemit elektronik ka drejtuar tek operatorët ekonomikë ftesën për ofertë. Data e përcaktuar për hapjen e ofertave është data 29.09.2020 ora 13:00. Operatorët që i janë përgjigjur ftesës për dorëzimin e ofertës ekonomike janë:

- 2T 157,377,451.20
- Salillari 163,544,033.60
- GPG Company&Si-Si-Al 168,888,560

Në datën 29.09.2020 është zhvilluar faza e dorëzimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës.

II.5. Në datën 12.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin në pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. OE 2T shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	157,377,451.20	100	100	100	300
2	157,377,451.20	100	100	100	300

3	157,377,451.20	100	100	100	300
---	----------------	-----	-----	-----	-----

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 300 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	157,377,451.20	60	20	20	100
2	157,377,451.20	60	20	20	100
3	157,377,451.20	60	20	20	100

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 100 pikë.

2. OE “Salillari” shpk

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	163,544,033.60	96	100	100	296
2	163,544,033.60	96	100	100	296
3	163,544,033.60	96	100	100	296

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 296 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	163,544,033.60	57.6	20	20	97.6
2	163,544,033.60	57.6	20	20	97.6

3	163,544,033.60	57.6	20	20	97.6
---	----------------	------	----	----	------

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 97.6 pikë.

3. GPG Company&Si-Si-Al shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	168,888,560	93	75	100	268
2	168,888,560	93	75	100	268
3	168,888,560	93	75	100	268

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 268 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	168,888,560	55.8	15	20	90.8
2	168,888,560	55.8	15	20	90.8
3	168,888,560	55.8	15	20	90.8

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 90.8 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	2T	300	100
2	Salillari	296	97.6

3	G.P.G Company& Si – Si-Al	268	90.8
---	---------------------------	-----	------

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se më datë 16.10.2020 pranë autoritetit kontraktor ka paraqitur ankesë nga operatori ekonomik Salillari shpk . KSHA pasi shqyrtoi ankesën doli me vendim për pranimin e pjesshëm të ankesës.

II.7. Në datën 23.10.2020 KVO-ja ka kryer procesin e rivlerësimit me pikë të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

1. OE 2T shpk

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	157,377,451.20	100	70	100	270
2	157,377,451.20	100	70	100	270
3	157,377,451.20	100	70	100	270

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 270 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	157,377,451.20	60	14	20	94
2	157,377,451.20	60	14	20	94
3	157,377,451.20	60	14	20	94

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 94 pikë.

2. OE “Salillari” shpk

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	163,544,033.60	96	100	100	296
2	163,544,033.60	96	100	100	296
3	163,544,033.60	96	100	100	296

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 296 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	163,544,033.60	57.6	20	20	97.6
2	163,544,033.60	57.6	20	20	97.6
3	163,544,033.60	57.6	20	20	97.6

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 97.6 pikë.

3. GPG Company&Si-Si-Al shpk

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	168,888,560	93	75	100	268
2	168,888,560	93	75	100	268
3	168,888,560	93	75	100	268

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 268 pikë.

Pikët e mësipërme në % duke kthyer në pikë janë si më poshtë”

Anëtar i KVO-së	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët përvoja në punë e kompanisë në %	Pikë cilësia metodologjia makineri etj	Total në %
1	168,888,560	55.8	15	20	90.8
2	168,888,560	55.8	15	20	90.8
3	168,888,560	55.8	15	20	90.8

Operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mestare 90.8 pikë.

- Renditja përfundimtare e operatorëve ekonomikë do të jetë:

Nr.	Operatori ekonomik	Pikët mesatare në %	Pikët mesatare në pikë
1	Salillari	296	97.6
2	2T	270	94
3	GPG Company&Si-Si-Al	268	90.8

II.6. Në datën 27.10.2020 operatori ekonomik “2T” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me rivlerësimin e kryer nga KVO më datë 23.10.2020 në mënyrë të përmbledhur me pretendimet si më poshtë:

- *Vendimi i KVO duke marrë parasysh vlerësimet kontradiktore dhe të pajustificuara është një vendim haptazi në kundërshtim me përcaktimet e LPP rregullat e prokurimit publik, bazën tjetër logjore të aplikueshme në rastin e prokurimeve si dhe praktikën tuaj të vendimarrjeve të mëparshme. Në bazë të LPP për këtë procedurë prokurimi rivlerësimi i operatorëve ekonomikë pjesmarrës nuk mund të bëhet as nga autoriteti kontraktor dhe as me ankesë prandaj e quajmë shkelje rivlerësimin e bërë në datë 23.10.2020.*
- *Në vlerësimin nga KVO në datë 12.10.2020 OE 2T shpk ka marrë 300 pikë pasi plotëson të gjitha kriteret e vlerësimit si në cmim, përvojë në punë dhe në cilësi.*
- *Kompania jonë nuk është dakord me vlerësimin e KVO datë 23.10.2020 pasi ne përmbushim më së miri kriteret e përcaktimit të ofertës fituese:*
- *Për ofertën ekonomike më të favorshme ne kemi ofertim më të mirë nga të gjithë operatorët dhe marrim pikët maksimale të përcaktuara.*

- *Për përvoja puna me kemi dorëzuar listën e punëve që kemi patur në proces gjatë kohës të përcaktuar në tender dhe përfitojmë pikët maksimale të përcaktuara.*
- *Për cilësinë në përfitojmë pikët maksimale pasi i përmbushim të gjitha kriteret e përcaktuara në fazën e kërkesës për ofertë , në kërkesën për ofertë në kemi paraqitur dokumentat si më poshtë:*
- *Plani i menaxhimit social dhe mjedisor*
- *Plani i menaxhimit të trafikut*
- *Plani i sigurimit të cilësisë*
- *Sigurimi i shëndetit në punë*
- *Metodologjinë e punimeve*
- *Të gjitha dokumentat e lartpërmendura në i kemi paraqitur sipas kushteve teknike të zbatimit dhe specifikimeve teknike të ofruara nga AK në fazën e tenderit ku ne i plotësojmë me stafin inxhiniero teknik si edhe me makineritë e kërkuara.*
- *Kërkojmë pranimin e ankesës duke lënë në fuqi vlerësimin e paraqitur në datë 12.10.2020.*

II.7. Në datën 02.11.2020 nëpërmjet shkresës me nr.8186/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.8. Në datën 09.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 8781/1 prot., datë 18.11.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr..1444/2 datë 20.11.2020 me objekt “*Dërgim informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “2T” sh.p.k. mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me rivlerëimin e tij në pikë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 3, pika 18 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Procedurë e kufizuar*” është procedura, përmes së

cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë, por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor mund të dorëzojnë oferta.

III.1.2. Në nenin 31 “Kriteret për Vlerësimin e Ofertës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.*

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë.

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 4, “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore

Faza 1 – Parakualifikimi: *Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

Faza 2 - Ftesa për Ofertë: *Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët, të cilët, kanë plotësuar kërkesat për parakualifikim duke i ftuar të dorëzojnë një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën fituese.*

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët ☐

Ose

B) ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☒

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐☐ pikë

etj. ☐☐ pikë

Kriteret e Vleresimit**Pikët****(i) Çmimi më i ulët****[0-60]**

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(ii) Pervoja ne pune e kompanise**[0-20]**

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e relalizuuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit.

(iii) Cilësia**[0 - 20]**

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

III.1.5. Në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Ligjor” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, operatorëve ekonomikë i është kërkuar përmbushja e kushteve si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1. Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet me vlerë jo më të vogël se 30 % e fondit limit të lotit perkates, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, si dëshmi të paraqitet Kopje e kontratës së nënshkruar me ent publik, Vërtetim i lëshuar nga enti publik (ose formulari vlerësimi në rastet kur lëshohet një i tillë); ku të përcaktohet saktësisht cilesia e kryerjes së shërbimit/puneve dhe fakti nëse kontrata është realizuar me sukses. Dhe Faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimi i realizuar;
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi të paraqiten: faturat tatimore përkatëse të shitjes të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet/ punet e realizuara).

III.1.6. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të tre elementëve kryesorë, të tillë si oferta ekonomike më e favorshme, Pervoja ne pune e kompanise dhe cilësia e cila përfshin treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të

cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

Komisioni i Prokurimit Publik në analize të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “2T” sh.p.k. në fazën e dytë të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me komponentin e parë oferta ekonomike më e favorshme ka paraqitur formularin e ofertës në vlerën 157,377,451.20 lekë pa tvsh. Ndërsa në lidhje me komponentin e dytë Pervoja ne pune e kompanisë- Operatori ekonomik duhet të përshkruajë punet e realizuar ne forme CV, shoqeruar me vertetim punimesh, te kryera ne 10 viteve te fundit, operatori ekonomik “2T” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë :

- CV e Kompanisë në të cilën përshkruan eksperiencat lidhur me përvojën e ngjashme si vijon:
 - Deklaratë për përvojën në punë
 - Strategjitë e Menaxhimit të shendetit dhe sigurisë dhe planet e zbatimit.
1. Kontratë me objekt Loti i i Rikonstruksion i rrugës së Hani i Hotit Tamarë, me vlerë 2.153.255.604 lekë, viti 2011 shoqëruar me formular vlerësimi me vlerë e realizuar të kontratës 1.706.272.979 lekë me tvsh. Kontratë sipërmarrje me objekt Rikonstruksion i rrugës së Hani i Hotit Tamarë, me vlerë 860.935.006 lekë, viti 2011, shoqëruar me formular vlerësimi me vlerë e realizuar të kontratës 947.149.606.04 lekë me tvsh, shoqëruar me fatura tatimore, 2T nënkotaktor 40% i kompanisë Copri Construction Enterprises.
 2. Plani i i sigurimit të cilësisë
 3. Formular vlerësimi lëshuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit Vlera sipas kontrtës: 175.649.880 lekë pa tvsh., vlera e realizuar e kontratës: 269, 621.534 lekë pa tvsh. Me objekt Rikonstruksion i rrugës Vaqarr-Gropaj Kthesa e Kasharit, J.V. Alb Buiding shpk 60% dhe 2T sh.p.k. 40%. Shoqëruar me fatura tatimore, kontratë Viti 2013
 4. Plani i Menaxhimit të trafikut.
 5. Formular vlerësimi lëshuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit Vlera sipas kontrtës: 155.784.400 lekë pa tvsh., vlera e realizuar e kontratës: 159.895.227 lekë pa tvsh. Me objekt Rikonstruksion i rrugës që lidh Farkën me rrugën e Elbasanit, J.V. Alb Buiding shpk 40% dhe 2T sh.p.k. 60%. Shoqëruar me fatura tatimore, kontratë viti 2015.
 6. Plani i menaxhimit social dhe mjedisor
 7. Formular vlerësimi lëshuar nga Delegacioni i Bashkimit European Shqipëri me objekt me objekt: Punime për rikostruksionin dhe reahabilitimin e 3 shkollave profesionale në Durrës, Lezhë dhe Fier. me vlerë 2.879.568,24 Euro, viti 2013, J.V. 60%, shoqëruar me kontratë fatura tatimore.
 8. Formular vlerësimi lëshuar nga Delegacioni i Bashkimit European Shqipëri me objekt punime për ndërtimin e Bypass-it të Rrogzhinës me vlerë 5.649.390.22 euro, viti 2014 (nënkotaktor 30%), shoqëruar me kontratë , fatura tatimore.
 9. Formular vlerësimi lëshuar nga Delegacioni i Bashkimit European Shqipëri me objekt Punime për ndërtimin rrugës Grabom Kufiri me Malin e Zi me vlerë 822.675.02

- euro, viti 2015, (J.V. 51%, përqindja në bazë të zërave të kontratës), shoqëruar me kontratë, fatura tatimore.
10. Formular vlerësimi me objekt Ndërtim i sistemit të kanalizimeve në Vlorë Faza e 2, Vlera e realizuar e kontratës 3.716.513 Euro, viti 2016 (nënkotaktor 30%, 2T ka realizuar punime për Loti I: punime linjas punime në PS, punime për shtesën e impiantit të pastrimit të ujërave të zeza, punime të rehabilitimit të impiantit ekzistues), Kontratë, fatura tatimore.
 11. Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Finiq me objekt Rehabilitim rruga Pllakë-Kulluricë, Vlera e realizuar e kontratës 128.606.425,08 lekë, viti 2017, kontratë fatura tatimore. Kujdes deklaruar me vlerë 107.172.020,9 lekë.
 12. Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Finiq me objekt Rikonstruksion i rrugës Fitore-Aliko me vlerë 57.667.654,40 lekë, viti 2017, kontratë fatura tatimore.
 13. Formular vlerësimi lëshuar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a (K.E.SH) me objekt Rehabilitim i Digës së Rragamit Hec Vau i Dejës me vlere 81.729.433,85 lekë viti 2017, (J.V. 2T sh.p.k 60 %, Alko-Impex General Construction shpk :40%), Kontratë, fatura tatimore.
 14. Formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Tiranë me objekt Rikonstruksion i infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rruga Njazi Meka-Grogor Perlevec-Niko Avrami-Spiro Cipi-Fitnete Rexha-Myslim Keta-Skënder Vila –Lumi i Tiranës me vlerë të realizuar të kontratës 197.049.468 lekë, viti 2017 kontratë, fatura tatimore.
 15. Formular vlerësimi lëshuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me objekt Rikonstruksion i rrugës Ura e Corumit –Zhabiak –Ura e Cepanit me vlerë 181.682.962,78 lekë, viti 2017 (J.V. 50%. Të punimeve), kontratë fatura tatimore.
 16. Kontratë lidhur nëpërmjet Agjencia Kombëtare e Ujesjellës Kanalizime dhe “2T” sh.p.k. me objekt Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve në zonën e Durrësit me vlerë 620.712.707,48 lekë viti 2017.
 17. Formular vlerësimi lëshuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt Stabilizim i rrëshqitjes në aksin Tunel Elbasan km 17.36-17.46 segmenti 3 aksi Tiranë –Elbasan (dalje tuneli i Krrabës km 15.2-Elbasan Km 27 me vlerë 371.177.142,32 lekë viti 2018. Kontrata, fatura tatimore.
 18. Kontratë lidhur nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar me objekt Mirëmbajtja dhe siguria rrugore bazuar në rezultate Kontrata C Lot 3 RRMSP/CË/2015/3 Vlera e realizuar nga 2T sh.p.k. si nënkotaktor 3.405628,30 Euro viti 2015 (nënkotaktor 40%), fatura tatimore.
 19. Kontratë me objekt Mbrojtje lumore nga përmytja dhe erozioni të lumit Drinos, në zonën e Drinos suhe, Gjirokastër me vlerë 18.294.249 lekë, viti 2015.
 20. Vërtetim lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Jugor me objekt Mirëmbajtje rutinë me performancë aksi rrugor Berat –Corovodë 49.3 km vlera e realizuar deri tani 5.294.820 lekë Viti 2019.
 21. Vërtetim lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Jugor me objekt Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga Libonik-Lozhan Grabovë +rruga Lin Poogradec+rruga Voskop-Voskopojë 72 km, vlera e realizuar deri tani 29.862.364,16 lekë viti 2018.

22. Vërtetim lëshuar nga Drejtoria e Rajonit Jugor me objekt Mirëmbajtje rutinë dimërore me performancë aksi rrugor K/Strele-K/Maliq i Oparit (rruga zëvendësuese M03)+aksi rrugor Shkëmbi i Dobercanit-Kufi Gramsh 19.3 km vlera e realizuar deri më tani 5.082.960 lekë viti 2019.

23. Vërtetim Punimesh lëshuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar me objekt Mirëmbajtje dimërore me performancë Rruga Kryqëzimi Lin Hyrja Pogradec 18 km, me vlerë 792.000 lekë viti 2017.

III.1.7. KPP vlen të sqarojë se ka një dallim të qartë midis kriterëve të vecanta për kualifikim në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së ngjashme gjatë tre viteve të fundit të hartuar në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, dhe kriterit të përcaktimit të ofertës fituese. Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se nga ana e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës së prokurimit, janë vlerësuar nga ana e autoritetit kontraktor se disponojnë eksperiencë të ngjashme, për rrjedhojë vlerësimi i kapacitetit teknik me pikë në fazën e dytë do të mbështet në një vlerësim të qëndrueshmërisë së eksperiencës teknike në 10 vitet e fundit në kontrata të ngjashme, dëshmisë së operatorët ekonomikë disponojnë eksperiencë dhe aftësi teknike për realizimin me sukses të kontratës, parë kjo gjithashtu edhe në rrafsh krahasimor me operatorin tjetër ekonomik. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se referuar objektit të prokurimit operatori ekonomik “2 T” sh.p.k., në veprimtarinë e tij shfaq një eksperience të gjatë dhe të thelluar në fushën e infrastrukturës dhe mirëmbajtjes rrugore. Me dokumentacionin e paraqitur ky operator ekonomik dëshmon se ka realizuar kontrata të ngjashme/të njëjta me objektin e prokurimit e si të tilla pretendimi i tij për një vlerësim maksimal të përcaktuar për këtë komponent, është tërësisht i bazuar. Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që cdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e mirëmbajtjes rrugore është plotësuar më së miri nga operatori ekonomik ankimues. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se, ankimuesi ka paraqitur një eksperiencë të gjatë e të ngjashme, madje dhe të njëjtë me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Pra, pretendimi i operatorit ekonomik “2T” sh.p.k. për të kërkuar rivlerësimin e pikëve rikonfirmon edhe një herë të drejtën e këtij operatori për të kërkuar maksimumin e pikëve, për sa kohë që nuk është evidentuar asnjë mangësi në dokumentacionin e paraqitur prej tij nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe komisionit të shqyrtimit të ankesës.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacion në lidhje me eksperiencat e mëparshme të ngjashme, duke paraqitur një sërë kontratash me objekt të ngjashëm e të njëjtë me objektin e prokurimit objekt shqyrtimi, çka rrjedhimisht duhet të vlerësohet, me vlerësimin maksimal me pikë nga ana e autoritetit kontraktor. Në kushtet kur, nga ana e operatorit ekonomik ankimues është dorëzuar një dokumentacion i plotë në lidhje me kontratat e ngjashme, duke u paraqitur një numër i konsiderueshëm kontratash të shtrira

në kohë dhe të lidhura dhe ekzekutuara me autoritete të ndryshme shtetërore dhe private, aq më tepër kur disa prej këtyre kontratave rezultojnë të ngjashme, rrjedhimisht vlerësimi do të bëhet në maksimumin e tij, bazuar dhe në frymën e legjislacionit për prokurimin publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të kryejë rivlerësim duke vlerësuar me pikët maksimale në lidhje me kriterin e eksperiencës së ngjashme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “2T” sh.p.k. qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, Vendit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “2T” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-65458-07-14-2020, me objekt Loti X “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Berat - Çorovode + rruga Çorovode - Hambull + rruga Hambull - Rog”, me fond limit 168,938,495.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktues brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “2T” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1444Prot.

Datë 09.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri